

## **Permbledhja e skemes se certifikimit.**

Ne skemen e certifikimit hyjne kompetenca dhe kerkesa te tjera lidhur me kategori specifike profesionale te personave. Kjo skemë certifikimi përdoret nga H.V.A.T. shpk për certifikimin e personave që përdorin pajisje elektrike të grupit të I, II, III, IV dhe V sipas përcaktimit në Urdhrin Nr. 3403/1 Prot. datë 30.06.2003 "Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike", miratuar nga Ministri i Industrisë dhe Energjetikës. Kjo skemë certifikimi i ofrohet në mënyrë jodiskriminuese të gjithë personave që aplikojnë për marrjen e dëshmisë së aftësisë dhe që plotësojnë kriteret vendosura në këtë skemë. Në nenin 7 të ligjit nr. 13/2013 kërkohet që "Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse".

## **Kerkesat per procesin e certifikimit fillestar.**

Të gjithë personat që kanë si qëllim të dëshmojnë aftësinë e tyre nëpërmjet certifikimit duhet të aplikojnë pranë H.V.A.T.A shpk e cila publikon në faqen zyrtare të saj përmbledhje të skemës së certifikimit dhe procesit të certifikimit, formatin e kërkesës aplikimit duke dhënë mundësinë

e aplikimit online. Gjithashtu shoqëria ve në dispozicion të personave që janë të interesuar të certifikohen, kete informacionin e përmbledhur të skemës së certifikimit, që nënshkruhet në fund nga çdo aplikant potencial dhe dorëzohet së bashku me kërkesën e firmosur (formular aplikimi) si dhe me dokumentacionin që vërteton kriteret paraprake e mësipërme sipas grupeve përkatëse.

Plotësimi i kërkesave vërtëtohet nga vlerësuesit paraprak. Nëse aplikanti plotëson kërkesat atëherë ai i nënshtrohet procesit të certifikimit, dhe kryen pagesën paraprakisht. Në rast se aplikanti nuk i plotëson kriteret atëherë vlerësuesi paraprak e lajmëron atë për kriteret që ai nuk plotëson dhe procedura e certifikimit nuk fillon.

Nëse kandidati tërhiqet nga procesi i ekzaminimit ai duhet të dërgoj një kërkesë me shkrim të paktën dy ditë përpara ekzaminimit, Në këtë rast kandidatit do t'i kthehet 50% e pagesës. Nëse kandidati kërkon që t'i nënshtrohet procesit të ekzaminimit në një datë të mëvonshme ai duhet të njoftojë me shkrim të paktën dy ditë përpara ekzaminimit dhe t'i propozojë trupës certifikuese një datë të përafërt, Kandidati që nuk njofton brenda afatit të përcaktuar nuk ka të drejtë të ngrej pretendimin për kthimin e pagesës.

Në raste të emergjencës, psh sëmundje, raste vdekjeje, kandidati njofton trupën certifikuese dhe paraqet pranë saj në kohën më të afërt dokumenta që vërtetojnë emergjencën.



**SHENIM:** Në rastet kur aplikanti është i huaj, organi certifikues mund të sigurojë përkthimin. Nëse do këtë kosto shtesëdo përballohet nga aplikanti.

## **Metodat e vleresimit**

Kandidatët i nënshtrohen procesit të vlerësimit nëpërmjet dy fazave:

1. ekzaminimit teorik me shkrim dhe me gojë
2. ekzaminimit praktik.

Kandidati duhet të rregjistrohet për të dyja fazat.

Vlerësimi përfundimtar mbështetet në rezultatet që kandidati merr në ekzaminimin me shkrim dhe ekzaminimin praktik. Kandidati konsiderohet se kalon me sukses vlerësimin e kompetencës teknike nëse ai merr të paktën 70% të pikëve si në ekzaminimin teorik me shkrim ashtu edhe në atë praktik.

Procesi i ekzaminimit të personave që përdorin pajisje elektrike kryhet në varësi të grupeve (kriteret e kompetencës)

## **Ekzaminimi teorik me shkrim.**

Pyetjet e ekzaminimit me shkrim do të jenë me alternativa dhe shtjelluese. Pyetjet me shkrim janë të hartuara sipas anekseve 1 të dokumentave "Procedura e ekzaminimit të personave që përdorin pajisje elektrike të klasifikuara sipas grupeve nga I deri tek V të sigurimit teknik elektrik. Në dokumentet e lartpërmendura jepet edhe klasifikimi i pyetjeve sipas vështirësisë së tyre.

Përgjigjet e kandidatëve nuk duhet të krahasohen njëri me tjetrin. Përgjigjet e pyetjeve për çdo grup jepen në anekset 2 të procedurave të ekzaminimit.

Kandidati konsiderohet se kalon me sukses ekzaminimin teorik me shkrim nëse përgjigjet e dhena prej tij konsiderohen të kënaqshme në një vlerë  $\geq 70\%$ . Nëse kandidati nuk arrin të marrë më shumë se 70% të pikëve, i mundësohet një ekzaminim i dytë teorik jo më herët se 7 ditë nga data e ekzaminimit të parë por jo më vonë se se pas 6 muajsh. Ekzaminimi i dytë kryhet njësoj si ekzaminimi i parë. Në rast të mos marrjes së të paktën të 70% të pikëve edhe në ekzaminimin e dytë teorik, kandidati i hiqet e drejta për vazhdimin e procesit të certifikimit. Në këtë rast kandidati duhet të aplikojë përsëri. Kandidati mund të aplikojë vetëm pasi të ketë kryer edhe njëherë trajnimin për standardet e përcaktuara në kriteret e kompetencës.

## **Ekzaminimi praktik**

1. Ekzaminimi praktik ka për qëllim që të vertetojë aftësitë praktike të kandidatëve që do të certifikohen lidhur me sigurimin teknik në detyra të ndryshme pune
2. Ekzaminimi praktik kryhet vetëm nëse kandidati ka marrë më shumë se 70% të pikëve në ekzaminimin teorik me shkrim.

Kandidati konsiderohet se kalon me sukses ekzaminimin praktiknëse totali i pikëve të vlerësimit  $\geq 70\%$ .

## **Procedura pas ekzaminimit.**

Përgjigjet për çështjet e mësipërme vlerësohen kundrejt procedurave përkatëse të ekzaminimit sipas kategorive të lartpërmendura.

Pas mbarimit të ekzaminimit, ekzaminuesi regjistron performancën e cdo kandidati. Rezultatet e cdo kandidati me shkrim dhe në ekzaminimin praktik duhet të jenë të firmosura nga ekzaminuesi. Në fund të cdo ekzaminimi, regjistrimet nga ekzaminimi dorëzohen tek komisioni i marrjes së vendimit.

## **Vendimi i certifikimit.**

H.V.A.T. shpik mbetet përgjegjës për marrjen e vendimit të certifikimit, ricertifikimit, pezullimit, tërheqjes, refuzimit dhe të zgjerimit së certifikimit.

Vendimi për certifikimin do të merret nga komisioni i marrjes së vendimit. Certifikimi sipas cdo grupi është i vlefshëm për 1 vit.

Nëse komisioni merr vendimin e refuzimit të aplikimit për certifikim, komisioni e lajmëron me shkrim kandidatin duke e njoftuar edhe për mundësinë për apelim.

## **Certifikata e certifikimit.**

Certifikata e certifikimit është dëshmia e aftësisë që kërkohet nga Ligji 13/2013. Elementet e certifikatës janë:



- a) emrin dhe stemën e Shoqërisë.
- b) numrin unik të identifikimit, datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi;
- c) të dhënat për identifikimin e titullarit të certifikatës ;
- d) një referencë tek skema e certifikimit;
- e) afatin e vlefshmërisë;
- f) nënshkrimin e përfaqësuesit të Shoqëriveqë janë pronare të skemës së certifikimit dhe vulën përkatëse të tyre;
- g) fushën e certifikimit;
- h) fotografinë e personit që certifikohet.

## **Perdorimi i certifikates.**

Përpara lëshimit të certifikatës, i kërkohet Personit të Çertifikuar, të nënshkruaj një deklaratë nëpërmjet së cilës ai pranon që:

- a) do të plotësoj përcaktimet përkatëse të skemës së certifikimit përfshirë çdo ndryshim të mundshëm të saj;
- b) do të bëjë aplikimin e certifikatës vetëm në lidhje me fushën e zbatimit për të cilën është dhënë certifikata;
- c) nuk do të përdorë certifikatën në një mënyrë të tillë që do t'i shkaktojë trupës së certifikimit cënimin e reputacionit;
- d) nuk do të bëjë asnjë deklaratë në lidhje me procesin e certifikimit të cilin trupa e certifikimit do ta konsideroj të gabuar dhe të paautorizuar.
- e) nuk do të përdorë certifikatën në mënyrë të gabuar.

## **Ndryshimi i kerkesave të certifikimit.**

H.V.A.T. shpk ka përgjegjësi të njoftojë personat e certifikuar në lidhje me çdo ndryshim që mund të ndodhë në kriteret për certifikim apo në procedurën e certifikimit. Në rast të ndryshimeve në kriteret për certifikim, H.V.A.T. shpk ka të drejtë të caktojë edhe periudha tranzitore të përshtatshme në varësi të ndryshimit. Periudha tranzitore do të jetë njësoj për çdo person të certifikuar.

**PT-HVAT-01/1**

**RISHIKIMI 00 DATE 06-11-2019**

PT-HVATI-01/1

RISHIKIMI 00 DATE 06-11-2019



## **Kerkesat per ricertifikimin.**

Certifikimi është i vlefshëm për 1 vit. Personat e certifikuar kanë të drejtë te ricertifikohen. Aplikimi për ricertifikim duhet të depozitohet të paktën njëmuaj përpara skadimit të certifikimit të mëparshëm.

Personi duhet të plotësojë kriteret e vendosura si për certifikimin fillestar.

## **Zgjerimi i certifikimit.**

Cdo person i certifikuar ka të drejtë të aplikojë për marrjen e certifikimit të një grupi më të lartë nëse ai plotëson kërkesat e grupit më të lartë dhe zbaton afatin kohor të detyrueshëm (3 muaj mbas certifikimit të fundit), të përcaktuar në Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit

Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike. Në këtë rast kandidati do t'i nënshtrohet procesit të ekzaminimit sipas kësaj skeme për certifikimin fillestar.

## **Ankesat dhe apelimet.**

Kandidati ose personi i certifikuar ka të drejtë të apelojë vendimet e marrë nga Apeli do të depozitohet tek trupa certifikuese jo më vonë se 10 ditë nga marrja e vendimit.

Kandidati, personi i certifikuar apo cdo person tjetër ka të drejtë të ankohet në lidhje me aktivitetin certifikues të H.V.A.T. shpk ose me aktivitetin e personit të certifikuar në lidhje me certifikimin sipas kësaj skeme

## **Kriteret per pezullimin dhe terheqjen e certifikimit.**

Kriteret për pezullimin janë:

1. Keq përdorimi i certifikatës së certifikimit
2. Performanca e keqe në kryerjen e detyrës sipas llojit të certifikimit
3. Mos marrja e veprimeve korrigjuese pas një ankese.
4. Shkelje e legjislacionit në fuqi që lidhet me fushën përkatëse
5. Mos plotësimi nga ana e të certifikuarit në një masë të konsiderueshme i ndonjërit prej termave dhe kushteve të certifikatës.
6. Rrezikimi ose dëmtimi i jetës, shëndetit, vlerave materiale, mjedisit.



7. Rrezikimi i jetës ose sigurisë së personave ose dëmtimi apo shkatërrimi i pronës.
8. Çertifikata përdoret në keqbesim dhe në kundërshtim me funksionet e saj.

Pezullimi i çertifikatës nuk mund vendoset për një kohë më të gjatë se 3 muaj ose tej kohëzgjatjes së vlefshmërisë së çertifikatës. Gjatë kohëzgjatjes së pezullimit të çertifikatës i çertifikuari duhet të korrigjojë moskonformitetet e gjetura. Nëse gjatë kësaj periudhe i çertifikuari nuk korrigjon shkaqet e pezullimit, çertifikata revokohet me vendim të Komisionit të Çertifikimit.

Kriteret për tërheqjen e certifikimit janë

1. Afati për pezullimin ka kaluar dhe personi i certifikuar vazhdon të mos plotësojë kriteret për certifikim.
2. Mos përshtatshmëria shëndetësore
3. Paraqitja e informacioneve që dëmtojnë imazhin e trupës certifikuese ose informacione të rreme.

Në rast tërheqjeje, personi i certifikuar duhet të kthej çertifikatën tek trupa certifikuese.

Personi i certifikuar në rast të mosplotësimit të një prej kërkesave të skemës së certifikimit mund të kërkojë vetë pezullimin ose tërheqjen e certifikimit.

## **Veprimet e pasigurta.**

Nëse para ose gjatë ekzaminimit, kandidati kryen veprime të pasigurta, ekzaminuesi ka të drejtë ta skualifikojë atë nga vazhdimi i ekzaminimit. Veprime të pasigurta mund të jenë:

1. Cdo veprim që në gjykimin e ekzaminuesit mund të dëmtojë personelin, ose pajisjet/instalimin.
2. Performancë jo korrekte me kërkesat e sigurimit teknik
3. Mos përdorimi i pajisjeve mbrojtëse

## **Kodi i sjelljes së personit të certifikuar**

Personi i certifikuar duhet të zbatojnë kodin e sjelljes të H.V.A.T. shpik gjatë periudhës së vlefshmërisë së certifikimit. Kodi i sjelljes përfshin:

Gjatë ushtrimit të aktivitetit si modernizues/modifikues i certifikuar:

- a) Do të jem i lirë nga cdo lloj ndikimi financiar, fetar, familjar, etj
- b) Do të mbroj interesin e përgjithshëm dhe mjedisin
- c) Do të sillem në mënyrë korrekte.

## Procesi i ankesave dhe i apelimeve.

- 1) Cdo aplikant kandidat apo person i certifikuar brenda 10 diteve nga dita e njoftimit ka te drejte te apeleje cdo veprim te kundert (te pafavorshem) te mare nga organi i certifikimit. Organi i certifikimit H.V.A.T qe lidhet me statusin e tij te deshruar te certifikimit. Apelimi paraqitet me shkrim prane organit certifikues H.V.A.T, ku ne te do te jete shenuar:
  - a. Personi qe ben apelin dhe adresen e sakte te tij
  - b. Vendimemarrja kunder te cilit behet apeli
  - c. Shkaqet per te cilat behet apeli
  - d. Cfare kerkohe nga apeli

Formulari i apelimt percaktohet ne dokumentin REG-H.V.A.T-06

Brenda pese diteve nga marrja e kerkeses ankimore organi certifikues fton ankuesin ne bisedime per gjetjen e zgjidhjes te problemit me marreveshje bazuar ne ligj dhe ne standart. Nese palet nuk gjejne zgjidhje me marveshjen krijohet komisioni i apelit. Ne komisionin e apelit organi certifikues do te marri masa qe mos te jene persona ne njejte te cilet kane marre pjese ne certifikimin e personit.

2) Aplikanti kandidati ose personi i certifikuar kur ka pakenaqesi ndaj H.V.A.T punonjesve te vecante te saj ne lidhje me veprime qe perbejne mospermbushje te rregullave dhe detyrave, ben ankese ne lidhje me sjelljen e mbajtur nga H.V.A.T ose nga ndonje pjestar tjeter i saj. Por pa kufizuar ne keto raste :

- a. Sjelljes se disa prej pjestareve ose te te gjitha grupit te ekzaminuesve, anetareve te komisionit te certifikimit etj.
- b. Punes se punonjesve te H.V.A.T gjate realizimit te sherbimeve administrative.
- c. Cfaredo lloj veprimtarie te pjestareve te H.V.A.T, qe i interesuari mendon se mund te krijojne paragjykime

**SHENIM:** ankese apo pakenaqesi mundet te bejne edhe grupet e interesit (psh. Punedhensesit) te cilet ndikohen nga puna dhe performanca e personit te certifikuar.

Formulari i ankimit percaktohet ne dokumentin REG-H.V.A.T-06

